

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	013	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	2689
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	3	Data: Datum: Date:	04,08,11
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 4 gusht 2015
Ref. nr: 230/018

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011) dhe dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:


V E N D I M

1. Të diplomuarit në programet e studimit për përgatitje të mësimdhënësve të ofruara nga Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), të regjistruar në programe të palicencuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-37 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), duhet të përfundojnë Programin për Avancimin e Kualifikimit.
2. Të diplomuarit në programet e palicencuara të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, përfshinë:
 - 2.1. Të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Universum - Dega Ferizaj, të regjistruar në vitin akademik 2007/2008;
 - 2.2. Të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Gjilani, të regjistruar në vitet akademike 2006/2007 dhe 2007/2008;
 - 2.3. Të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Vizioni Evropian, të regjistruar në vitet akademike 2006/2007 dhe 2007/2008;

3. Obligohet Departamenti për Arsim të Lartë të siguroj listën me të dhënat e sakta të diplomuarve në programet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, MASHT në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do të përgatisin dhe organizojnë Programin për Avancimin e Kualifikimit.
 - 4.1. Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në një afat kohor deri më 1 tetor 2015 do të përgatis një raport vlerësues të programeve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, duke përcaktuar barasvlerën e tyre me kualifikimin Baçelor i Edukimit katër (4) vjeçar dhe nevojën për plotësim të kualifikimit me përmbajtje të reja akademike dhe profesionale;
 - 4.2. Përmbajtja akademike dhe profesionale, forma e organizimit, kushtet e regjistrimit dhe afatet e realizimit të Programin për Avancimin e Kualifikimit do të përcaktohen nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
 - 4.3. Programi për Avancimin e Kualifikimit duhet të përfundoj më së largu deri më 31 dhjetor 2016;
5. Departamenti për Arsim të Lartë në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do të njoftojnë të gjithë të diplomuarit në programet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, për mundësitë dhe kushtet e regjistrimit në Programin për Avancimin e Kualifikimit.
6. Të gjithë mësimdhënësit e punësuar, të diplomuar në programet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, e vazhdojnë punën me kusht që të aplikojnë dhe përfundojnë me sukses Programin për Avancimin e Kualifikimit, më së largu deri më 31 dhjetor 2016.
7. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit të zbatoj procedurat e licencimit të mësimdhënësve për të gjithë të diplomuarit në programet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, pas përfundimit me sukses të Programit për Avancimin e Kualifikimit dhe sipas legjislacionit në fuqi.
8. Ministri i MASHT do të themelojë një Komision të përbërë prej ekspertëve dhe palëve të përfshira për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi, i cili komision do t'i raportoj me shkrim Ministrin, çdo tre (3) muaj, për zbatimin e këtij vendimi.
9. Obligohet Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar që të ua dërgojë këtë vendim të gjitha Drejtorie Komunale për Arsim.

10. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

pa Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, Ministër



Iu dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive Komunale për Arsim;
- Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
- Departamenti për Arsimin e Lartë, MASHT;
- Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar;
- Arkivit të MASHT.